REXHI®

Code of Conduct

Rexhi Group
Rr. Mursel Rexhi 1056
KS-60510 Bresalc

Inhaltsverzeichnis / Përmbajtja / Contents

Sprachdarstellung / *Paraqitja e gjuhëve* / Language presentation: **Deutsch** | *Shqip* | English

1 Zweck und Geltungsbereich / *Qëllimi dhe fusha e zbatimit* / Purpose and scope

2 Grundsätze und rechtmäßiges Handeln / *Parimet dhe veprimi i ligjshëm* / Principles and lawful conduct

3 Arbeitnehmerrechte und Arbeitsbedingungen / *Të drejtat e punonjësve dhe kushtet e punës* / Employee rights and working conditions

3.1 Vereinigungsfreiheit und Tarifverhandlungen / *Liria e organizimit dhe negociatat kolektive* / Freedom of association and collective bargaining

4 Menschenrechte, Kinderarbeit und Zwangsarbeit / *Të drejtat e njeriut, puna e fëmijëve dhe puna e detyruar* / Human rights, child labour and forced labour

5 Arbeitssicherheit und Gesundheitsschutz / *Siguria dhe shëndeti në punë* / Occupational health and safety

6 Geschäftsethik und Compliance / *Etika e biznesit dhe pajtueshmëria* / Business ethics and compliance

6.1 Schutz von Vermögen, Informationen und Daten / *Mbrojtja e pasurisë, informatave dhe të dhënave* / Protection of assets, information and data

6.2 Umwelt und Klimaschutz / *Mbrojtja e mjedisit dhe klimës* / Environment and climate protection

7 Anforderungen an Lieferanten und Geschäftspartner / *Kërkesat për furnitorët dhe partnerët afaristë* / Requirements for suppliers and business partners

7.1 Konfliktmineralien und verantwortliche Beschaffung / *Mineralet e konfliktit dhe furnizimi i përgjegjshëm* / Conflict minerals and responsible sourcing

7.2 Überprüfung und Abhilfemaßnahmen bei Geschäftspartnern / *Kontrolli dhe masat korrigjuese te partnerët* / Business partner verification and corrective actions

8 Meldung von Verstößen und Schutz vor Repressalien / *Raportimi i shkeljeve dhe mbrojtja nga hakmarrja* / Reporting concerns and protection against retaliation

9 Umsetzung, Kommunikation und Überwachung / *Zbatimi, komunikimi dhe monitorimi* / Implementation, communication and monitoring

10 Inkrafttreten und Freigabe / *Hyrja në fuqi dhe miratimi* / Effective date and approval

1 Zweck und Geltungsbereich / *Qëllimi dhe fusha e zbatimit* / Purpose and scope

Dieser Code of Conduct legt die verbindlichen Grundsätze für integres, rechtmäßiges und verantwortungsbewusstes Handeln der Rexhi GmbH in Deutschland und Rexhi Sh.p.k. im Kosovo (gemeinsam „Rexhi Group“) fest. Er gilt für Geschäftsführungen, Führungskräfte und Beschäftigte beider Gesellschaften. Anforderungen an Lieferanten und Geschäftspartner sind in Kapitel 7 enthalten und werden durch vertragliche Einbeziehung verbindlich. Anwendbares zwingendes Recht beider Länder bleibt unberührt.

Ky Kod i Sjelljes përcakton parimet e detyrueshme për veprim të ndershëm, të ligjshëm dhe të përgjegjshëm të Rexhi GmbH në Gjermani dhe Rexhi Sh.p.k. në Kosovë (së bashku “Rexhi Group”). Ai zbatohet për drejtuesit, menaxherët dhe punonjësit e të dy shoqërive. Kërkesat për furnitorët dhe partnerët afaristë janë në kapitullin 7 dhe bëhen të detyrueshme kur përfshihen në marrëveshje. Legjislacioni i detyrueshëm i secilit vend mbetet në fuqi.

This Code of Conduct sets binding principles for ethical, lawful and responsible conduct at Rexhi GmbH in Germany and Rexhi Sh.p.k. in Kosovo (together, the “Rexhi Group”). It applies to management, executives and employees of both entities. Requirements for suppliers and business partners appear in section 7 and become contractually binding when incorporated into agreements. Mandatory local law remains applicable.

2 Grundsätze und rechtmäßiges Handeln / *Parimet dhe veprimi i ligjshëm* / Principles and lawful conduct

Die Rexhi Group handelt ehrlich, fair und transparent und beachtet die jeweils geltenden Gesetze, behördlichen Vorgaben und vertraglichen Verpflichtungen. Geschäftsführung und Führungskräfte tragen Verantwortung für die Umsetzung, fördern eine offene Unternehmenskultur und stellen geeignete Ressourcen bereit. Bei widersprechenden Vorgaben wird die zuständige Compliance Funktion einbezogen; zwingendes Recht hat Vorrang.

Rexhi Group vepron me ndershmëri, drejtësi dhe transparencë dhe respekton ligjet, kërkesat e autoriteteve dhe detyrimet kontraktuale përkatëse. Drejtoria dhe udhëheqësit janë përgjegjës për zbatimin, promovojnë kulturë të hapur dhe sigurojnë burime të përshtatshme. Në rast kërkesash kundërthënëse konsultohet përgjegjësi për pajtueshmëri; ligji detyrues ka përparësi.

The Rexhi Group acts honestly, fairly and transparently and complies with applicable laws, regulatory requirements and contractual obligations. Management is responsible for implementation, an open corporate culture and appropriate resources. Conflicting requirements must be referred to the compliance function; mandatory law prevails.

3 Arbeitnehmerrechte und Arbeitsbedingungen / *Të drejtat e punonjësve dhe kushtet e punës* / Employee rights and working conditions

Die Rexhi Group gewährleistet faire Arbeitsbedingungen, angemessene und gesetzeskonforme Entlohnung, dokumentierte Arbeitszeiten, Ruhezeiten sowie den gesetzlich vorgesehenen Urlaub. Diskriminierung, Belästigung und Einschüchterung werden nicht geduldet. Alle Beschäftigten haben freien Zugang zu Trinkwasser, Sanitäranlagen und Pausenbereichen; ihre Bewegungsfreiheit darf nicht rechtswidrig eingeschränkt werden. Personaldaten und Beschäftigungsbedingungen werden vertraulich behandelt.

Rexhi Group siguron kushte të drejta pune, pagesë të përshtatshme në përputhje me ligjin, regjistrim të orarit të punës, pushime dhe leje sipas ligjit. Diskriminimi, ngacmimi dhe frikësimi nuk tolerohen. Të gjithë punonjësit kanë qasje të lirë në ujë të pijshëm, tualete dhe hapësira pushimi; liria e lëvizjes nuk kufizohet në mënyrë të paligjshme. Të dhënat e personelit dhe kushtet e punës trajtohen në mënyrë konfidenciale.

The Rexhi Group provides fair working conditions, appropriate pay in compliance with the law, recorded working hours, rest periods and statutory leave. Discrimination, harassment and intimidation are not tolerated. All workers have free access to drinking water, toilets and rest facilities; freedom of movement must not be unlawfully restricted. Personnel information is handled confidentially.

3.1 Vereinigungsfreiheit und Tarifverhandlungen / *Liria e organizimit dhe negociatat kolektive* / Freedom of association and collective bargaining

Die Rexhi Group respektiert das Recht aller Beschäftigten, Arbeitnehmervertretungen und Gewerkschaften nach geltendem Recht zu bilden oder ihnen beizutreten beziehungsweise nicht beizutreten sowie an rechtmäßigen kollektiven Verhandlungen teilzunehmen. Aus der rechtmäßigen Wahrnehmung dieser Rechte dürfen keine Nachteile entstehen. Ansprechpartner ist die zuständige Personalverantwortung der jeweiligen Gesellschaft.

Rexhi Group respekton të drejtën e çdo punonjësi për të themeluar ose për t'iu bashkuar, apo për të mos iu bashkuar, përfaqësimeve të punonjësve dhe sindikatave sipas ligjit, si dhe për të marrë pjesë në negociata kolektive të ligjshme. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk guxon të sjellë pasoja negative. Kontakt është përgjegjësi për personelin i shoqërisë përkatëse.

The Rexhi Group respects employees' rights to establish, join or refrain from joining employee representative bodies and trade unions under applicable law, and to participate in lawful collective bargaining. No disadvantage may result from exercising these rights. The responsible local HR function is the contact point.

4 Menschenrechte, Kinderarbeit und Zwangsarbeit / *Të drejtat e njeriut, puna e fëmijëve dhe puna e detyruar* / Human rights, child labour and forced labour

Die Rexhi Group achtet die international anerkannten Menschenrechte und orientiert sich an den UN Leitprinzipien für Wirtschaft und Menschenrechte, den ILO Kernarbeitsnormen und den OECD Leitsätzen für verantwortungsvolles unternehmerisches Handeln. Kinderarbeit, Menschenhandel, Schuldknechtschaft und jede Form von Zwangsarbeit sind verboten. Vor der Einstellung wird das gesetzliche Mindestalter überprüft. Für Beschäftigte unter 18 Jahren gelten besondere Schutzvorschriften; gefährliche Tätigkeiten und unzulässige Nachtarbeit sind ausgeschlossen. Ausweisdokumente dürfen nicht als Druckmittel einbehalten werden.

Rexhi Group respekton të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe orientohet nga Parimet Udhëzuese të OKB për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut, standardet bazë të ILO dhe udhëzimet e OECD për sjellje të përgjegjshme. Puna e fëmijëve, trafikimi i njerëzve, puna për shlyerje borxhi dhe çdo formë e punës së detyruar ndalohen. Mosha ligjore verifikohet para punësimit. Për personat nën 18 vjeç zbatohen mbrojtje të veçanta; ndalohen punët e rrezikshme dhe puna e natës kur nuk lejohet. Dokumentet personale nuk mbahen si mjet presioni.

The Rexhi Group respects internationally recognised human rights and is guided by the UN Guiding Principles on Business and Human Rights, ILO core labour standards and OECD Guidelines for Responsible Business Conduct. Child labour, human trafficking, debt bondage and all forms of forced labour are prohibited. Legal minimum age is verified before employment. Special safeguards apply to workers under 18; hazardous work and unlawful night work are prohibited. Identity documents must not be retained as coercion.

5 Arbeitssicherheit und Gesundheitsschutz / *Siguria dhe shëndeti në punë* / Occupational health and safety

Die Rexhi Group verpflichtet sich zu sicheren und gesundheitsgerechten Arbeitsbedingungen. Gefährdungen werden bewertet, geeignete Schutzmaßnahmen einschließlich PSA umgesetzt und Mitarbeiter regel-

mäßig unterwiesen. Unfälle und Beinaheunfälle werden gemeldet und ausgewertet. Notfallvorsorge umfasst standortbezogene Alarmierung, Evakuierung, Brandbekämpfung und Erste Hilfe. Verantwortlichkeiten und konkrete Maßnahmen sind im QMS und in den Standortregelungen festgelegt.

Rexhi Group angazhohet për kushte të sigurta dhe të shëndetshme pune. Rreziqet vlerësohen, zbatohen masat e përshtatshme mbrojtëse, përfshirë pajisjet personale mbrojtëse, dhe punonjësit trajnohen rregullisht. Aksidentet dhe incidentet e shmangura raportohen e analizohen. Përgatitja për emergjenca përfshin alarmimin, evakuimin, mbrojtjen nga zjarri dhe ndihmën e parë sipas lokacionit. Përgjegjësitë dhe masat përcaktohen në QMS dhe rregulloret lokale.

The Rexhi Group is committed to safe and healthy working conditions. Risks are assessed, suitable protective measures including PPE are implemented, and workers receive regular instructions. Accidents and near misses are reported and analysed. Emergency preparedness covers local alarms, evacuation, firefighting and first aid. Responsibilities and details are set out in the QMS and site procedures.

6 Geschäftsethik und Compliance / *Etika e biznesit dhe pajtueshmëria* / Business ethics and compliance

Die Rexhi Group untersagt Bestechung und Korruption, unzulässige Zuwendungen, wettbewerbswidrige Absprachen, Betrug, Geldwäsche und unrichtige Geschäftsaufzeichnungen. Geschenke und Einladungen dürfen geschäftliche Entscheidungen nicht beeinflussen und unterliegen der Antikorruptionsrichtlinie. Private oder finanzielle Interessenkonflikte sind offenzulegen; betroffene Personen dürfen nicht über Vorgänge entscheiden, bei denen ihre Unabhängigkeit gefährdet ist. Auffällige Zahlungsvorgänge sind vor Ausführung zu klären.

Rexhi Group ndalon ryshfetin dhe korrupsionin, përfitimet e palejuara, marrëveshjet kundër konkurrencës, mashtrimin, pastrimin e parave dhe regjistrimet e pasakta afariste. Dhuratat dhe ftesat nuk mund të ndikojnë në vendimet e biznesit dhe rregullohen nga politika kundër korrupsionit. Konfliktet personale ose financiare të interesit duhet të deklarohen; personat e përfshirë nuk vendosin kur pavarësia e tyre rrezikohet. Pagesat e dyshimta duhet të sqarohen para ekzekutimit.

The Rexhi Group prohibits bribery and corruption, improper benefits, anti competitive arrangements, fraud, money laundering and inaccurate business records. Gifts and hospitality must not influence business decisions and are governed by the anti corruption policy. Personal or financial conflicts must be disclosed; affected persons must withdraw from decisions where independence may be compromised. Suspicious payments must be clarified before processing.

6.1 Schutz von Vermögen, Informationen und Daten / *Mbrojtja e pasurisë, informatave dhe të dhënave* / Protection of assets, information and data

Unternehmenseigentum und geistiges Eigentum sind sorgfältig zu schützen. Geschäftsunterlagen und Buchungen müssen wahrheitsgemäß, nachvollziehbar und vollständig sein. Vertrauliche technische, finanzielle und personenbezogene Daten werden nur für legitime Zwecke und im Einklang mit den jeweils anwendbaren Datenschutzvorschriften verarbeitet. Zugriffe auf Informationen erfolgen nach dem Prinzip der erforderlichen Berechtigung.

Pasuria dhe pronësia intelektuale e kompanisë duhet të mbrohen me kujdes. Dokumentet dhe regjistrimet financiare duhet të jenë të sakta, të gjurmueshme dhe të plota. Të dhënat teknike, financiare dhe personale konfidenciale përpunohen vetëm për qëllime legjitime dhe sipas ligjeve përkatëse të mbrojtjes së të dhënave. Qasja lejohet vetëm sipas nevojës dhe autorizimit.

Company property and intellectual property must be protected. Business records and accounting entries must be accurate, traceable and complete. Confidential technical, financial and personal data are processed only for legitimate purposes and in accordance with applicable data protection laws. Information access is limited to authorised personnel with a business need.

6.2 Umwelt und Klimaschutz / *Mbrojtja e mjedisit dhe klimës* / Environment and climate protection

Die Rexhi Group verpflichtet sich zum Schutz von Luft, Wasser, Boden und natürlichen Ressourcen. Gesetzliche Vorgaben zu Gefahrstoffen, Emissionen und Abfällen werden eingehalten. Wir fördern Abfallvermeidung, Wiederverwendung, Materialeffizienz und einen sparsamen Energieverbrauch. Umweltvorfälle sind unverzüglich zu melden. Umweltziele und Maßnahmen, einschließlich Ansätzen zur Reduzierung von Treibhausgasemissionen, werden in den einschlägigen Managementprozessen festgelegt und überprüft.

Rexhi Group angazhohet për mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës dhe burimeve natyrore. Respektohen rregullat ligjore për substancat e rrezikshme, emetimet dhe mbetjet. Nxisim shmangien e mbetjeve, ripërdorimin, efikasitetin e materialeve dhe kursimin e energjisë. Incidentet mjedisore raportohen menjëherë. Objektivat dhe masat mjedisore, përfshirë uljen e emetimeve të gazeve serrë, përcaktohen dhe kontrollohen në proceset e menaxhimit.

The Rexhi Group is committed to protecting air, water, soil and natural resources. Applicable requirements for hazardous substances, emissions and waste are observed. We promote waste prevention, reuse, material efficiency and energy conservation. Environmental incidents must be reported promptly. Environmental targets and actions, including greenhouse gas reduction measures, are set and reviewed through the relevant management processes.

7 Anforderungen an Lieferanten und Geschäftspartner / *Kërkesat për furnitorët dhe partnerët afaristë* / Requirements for suppliers and business partners

Die Rexhi Group erwartet von Lieferanten, Dienstleistern und anderen Geschäftspartnern die Einhaltung der in diesem Kodex formulierten Grundsätze, soweit sie für deren Tätigkeiten relevant sind. Dazu gehören faire Arbeitsbedingungen, Vereinigungsfreiheit, Menschenrechte, das Verbot von Kinderarbeit und Zwangsarbeit, Gesundheitsschutz, Korruptionsvermeidung, fairer Wettbewerb, Geldwäscheprävention und Umweltschutz. Diese Anforderungen werden durch ausdrückliche Einbeziehung dieses Kodex in Bestellungen, Verträge oder Einkaufsbedingungen vertraglich verbindlich; die Veröffentlichung allein begründet keine vertragliche Bindung.

Rexhi Group pret nga furnitorët, ofruesit e shërbimeve dhe partnerët e tjerë afaristë respektimin e parimeve të këtij kodi, kur janë të zbatueshme për veprimtarinë e tyre. Këto përfshijnë kushte të drejta pune, lirinë e organizimit, të drejtat e njeriut, ndalimin e punës së fëmijëve dhe të detyruar, sigurinë në punë, parandalimin e korrupsionit, konkurrencën e drejtë, parandalimin e pastrimit të parave dhe mbrojtjen e mjedisit. Kërkesat bëhen detyruese me përfshirjen e shprehur të kodit në porosi, kontrata ose kushtet e blerjes; publikimi i vetëm nuk krijon detyrim kontraktual.

The Rexhi Group expects suppliers, service providers and other business partners to observe the principles of this Code where relevant to their activities, including fair working conditions, freedom of association, human rights, prohibition of child and forced labour, occupational safety, anti corruption, fair competition, anti money laundering and environmental protection. These requirements become contractually binding when this Code is expressly incorporated into purchase orders, contracts or purchasing terms. Publication alone does not create a contractual obligation.

7.1 Konfliktmineralien und verantwortliche Beschaffung / *Mineralet e konfliktit dhe furnizimi i përgjegjshëm* / Conflict minerals and responsible sourcing

Lieferanten müssen auf Anfrage angemessene Informationen zur Herkunft und Lieferkette relevanter Mineralien und Metalle, insbesondere Zinn, Tantal, Wolfram und Gold, zur Verfügung stellen. Beschaffung aus Konfliktgebieten oder Hochrisikogebieten ist risikobasiert zu bewerten. Identifizierte Risiken sind durch geeignete Sorgfaltsmaßnahmen und Korrekturen zu reduzieren; anwendbare rechtliche Anforderungen sind einzuhalten. Eine pauschale Garantie konfliktfreier Herkunft ohne Nachweise wird nicht verlangt.

Furnitorët, sipas kërkesës, duhet të japin informata të përshtatshme mbi origjinën dhe zinxhirin e furnizimit të mineraleve dhe metaleve përkatëse, veçanërisht kallajit, tantalit, volframit dhe arit. Furnizimi nga zonat e konfliktit ose me rrezik të

lartë duhet të vlerësohet sipas rrezikut. Rreziqet e identifikuara zvogëlohen përmes masave të kujdesit të duhur dhe korrigjimeve; respektohen ligjet e zbatueshme. Nuk kërkohet garanci e përgjithshme pa dëshmi për origjinë pa konflikt.

Suppliers must provide reasonable information on the origin and supply chain of relevant minerals and metals, in particular tin, tantalum, tungsten and gold, upon request. Sourcing from conflict affected or high risk areas must be assessed on a risk basis. Identified risks are mitigated through appropriate due diligence and corrective action in line with applicable law. Unsupported blanket claims of conflict free origin are not required.

7.2 Überprüfung und Abhilfemaßnahmen bei Geschäftspartnern / *Kontrolli dhe masat korrigjuese te partnerët* / Business partner verification and corrective actions

Die Rexhi Group überprüft die Einhaltung risikobasiert durch Lieferantenbewertungen, Selbstauskünfte, geeignete Nachweise und erforderlichenfalls vereinbarte Audits. Lieferanten sollen relevante Erwartungen angemessen an ihre eigenen Lieferanten weitergeben. Bei begründetem Verdacht auf Verstöße sind Informationen bereitzustellen und gemeinsam Abhilfemaßnahmen mit Fristen festzulegen. Vertragsrechtliche Folgen richten sich nach den jeweils vereinbarten Bedingungen und dem anwendbaren Recht.

Rexhi Group kontrollon respektimin sipas rrezikut përmes vlerësimeve të furnitorëve, vetëdeklarimeve, dëshmive të përshtatshme dhe, kur nevojitet, auditimeve të dakorduara. Furnitorët duhet t'ua përcjellin pritjet përkatëse furnitorëve të tyre. Kur ekziston dyshim i arsyeshëm për shkelje, kërkohen informata dhe përcaktohen masa korrigjuese me afate. Pasojat kontraktuale varen nga marrëveshjet dhe ligji i zbatueshëm.

The Rexhi Group assesses compliance on a risk basis through supplier evaluations, self assessments, appropriate evidence and, where necessary, agreed audits. Suppliers should communicate relevant expectations to their own suppliers. Reasonably suspected breaches require cooperation, information and time bound corrective measures. Contractual consequences are governed by the agreed terms and applicable law.

8 Meldung von Verstößen und Schutz vor Repressalien / *Raportimi i shkeljeve dhe mbrojtja nga hakmarrja* / Reporting concerns and protection against retaliation

Beschäftigte und Geschäftspartner können tatsächliche oder vermutete Verstöße vertraulich melden. Meldungen können an die zuständige Compliance Funktion, die Personalverantwortung oder die Geschäftsführung erfolgen. Meldungen in gutem Glauben dürfen nicht zu Benachteiligung führen. Vertraulichkeit, Schutz personenbezogener Daten, unparteiische Prüfung und angemessene Folgemaßnahmen sind zu gewährleisten. Die Möglichkeit anonymer Meldungen wird erst zugesichert, wenn ein entsprechender Kanal betriebsbereit ist.

Punonjësit dhe partnerët afaristë mund të raportojnë në mënyrë konfidenciale shkelje të vërteta ose të dyshuara. Raportimet mund t'i drejtohen përgjegjësit për pajtueshmëri, personelit ose drejtorisë. Raportimi me mirëbesim nuk guxon të sjellë pasoja negative. Duhet të sigurohen konfidencialiteti, mbrojtja e të dhënave, shqyrtimi i paanshëm dhe masat përkatëse. Raportimi anonim premtohet vetëm kur kanali është funksional.

Employees and business partners may report actual or suspected misconduct confidentially to the responsible compliance function, HR or management. Good faith reports must not result in retaliation. Confidentiality, data protection, impartial review and proportionate follow up are required. Anonymous reporting is only represented as available once the relevant channel is operational.

9 Umsetzung, Kommunikation und Überwachung / *Zbatimi, komunikimi dhe monitorimi* / Implementation, communication and monitoring

Die Geschäftsführungen beider Gesellschaften tragen die Gesamtverantwortung; Zuständigkeiten werden in den Stellenbeschreibungen und in der Verantwortlichkeitsmatrix festgelegt. Der Code wird Beschäftigten bekannt gemacht und bei Eintritt sowie anlassbezogen erläutert. Die Einhaltung wird mindestens jährlich

und bei wesentlichen Änderungen bewertet. Festgestellte Abweichungen führen zu angemessenen Korrekturmaßnahmen. Interne Verstöße können arbeitsrechtliche Folgen nach anwendbarem Recht haben; externe Verstöße werden entsprechend den Vertragsbedingungen bearbeitet.

Drejtoritë e të dy shoqërive kanë përgjegjësinë e përgjithshme; kompetencat caktohen në përshkrimet e vendeve të punës dhe matricën e përgjegjësive. Kodi u komunikohet punonjësve gjatë fillimit të punës dhe sipas nevojës. Zbatimi vlerësohet të paktën çdo vit dhe kur ka ndryshime të rëndësishme. Devijimet sjellin masa korrigjuese. Shkeljet e brendshme mund të sjellin pasoja sipas ligjit të punës; shkeljet e jashtme trajtohen sipas kushteve kontraktuale.

Management of both entities is ultimately responsible; duties are assigned through job descriptions and the responsibility matrix. Employees receive the Code at onboarding and as needed. Compliance is reviewed at least annually and following material changes. Non conformities result in appropriate corrective actions. Internal breaches may trigger employment consequences under applicable law; external breaches are handled under contract terms.

10 Inkrafttreten und Freigabe / *Hyrja në fuqi dhe miratimi* / Effective date and approval

Dieser Code of Conduct (UR-RX-01) tritt mit der dokumentierten Freigabe durch die jeweils zuständigen Geschäftsführungen der Rexhi GmbH und Rexhi Sh.p.k. in Kraft und ersetzt die vorherige Revision. Die Freigabe einschließlich der freigebenden Personen, des Freigabedatums sowie der Revisionshistorie wird im zentralen Dokumentenmanagementsystem der Rexhi Group nachvollziehbar dokumentiert. Eine handschriftliche Unterschrift auf der veröffentlichten Fassung ist nicht erforderlich.

Ky Kod i Sjelljes (UR-RX-01) hyn në fuqi pas miratimit të dokumentuar nga drejtuesit përkatës të Rexhi GmbH dhe Rexhi Sh.p.k. dhe zëvendëson revizionin e mëparshëm. Miratimi, përfshirë personat që e kanë miratuar, datën e miratimit dhe historikun e revizioneve, dokumentohet në mënyrë të gjurmueshme në sistemin qendror të menaxhimit të dokumenteve të Rexhi Group. Nuk kërkohet nënshkrim me dorë në versionin e publikuar.

This Code of Conduct (UR-RX-01) takes effect upon documented approval by the respective authorised management of Rexhi GmbH and Rexhi Sh.p.k. and supersedes the previous revision. The approval, including the approving persons, approval dates and revision history, is recorded in a traceable manner in the Rexhi Group central document management system. A handwritten signature is not required on the published version.